

Në Kosovë po afron kalimi në Euro Si ndikon përdorimi i valutës së re në biznesin tuaj në Kosovë

Futja në përdorim e Euro-s me 1 Janar 2002 është një operacion shumë më kompleks se kalimi në DM (markën gjermane) pas luftës. Pasi që DM është përdorur një kohë të gjatë paralel me dinarin Jugosllav, është mjaft vështirë që të adoptohet një sistem i ri. Pra, Kosova duhet të importojë paranë e re dhe të eksportojë DM-në e vjetër. Me tonelata para të letrës dhe aso metalike duhet të kalojnë kufijtë. Kalimi në euro në Kosovë është më i komplikuar sepse mungon një gjë e thjeshtë: xhirollogaria personale bankare.

Se çka do të aplikohet për qytetarët është shumë më e rëndësishme për kompanitë. Periudha e qarkullimit dual përfundon vetëm dy muaj pas fillimit të kalimit në euro, me 28 Shkurt 2002. Pas këtyre dy muajve pagesat në DM më nuk pranohen dhe çka është më e rëndësishme në Kosovë nuk do të ketë më shëndërrim në Euro pa provision bankar. Secili që deri atëherë nuk bën shëndërrimin e DM-ve të tijë ose të saj do të ballafaqohet me një seri problemesh. Për këtë arsye iu rekomandojmë qytetarëve si dhe kompanive që menjëherë të hapin xhirollogaritë bankare. Atëherë çdo markë e depozituar automatikisht do të shëndërron në euro pa kurrfarë provisioni.

Kalimi në euro menaxhohet nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK), i cili ka formuar qysh heret një grup të posaçëm punues për këtë detyrë. E ashtuquajtura "periudha kalimtare" do të përfundojë me 31 Dhjetor të këtij viti. Deri atëherë BPK aplikon rregulloren "që nuk ndalon e as obligon" adoptimin e euro-s në transaksionet bankiere që nuk janë kesh, kontabilitet, buxhet, raportet financiare, xhirollogari bankiere, çmime duale dhe pagesa të obligueshme.

Mirëpo, kompanitë kanë një kohë mjaft të shkurtë që të pregadisnin biznesin e tyre për këtë kalim. Listat e çmimeve duale nuk janë ekspozuar gjithkund. Për konsumatorin mbetet ende vështirë që të përshtatet pas së re. Duke e marrë parasysh faktin se, fushata informative në Shtetet anëtare të BE-së ka filluar para më tepër se dy viteve, publiku i gjërë në Kosovë ende din shumë pak lidhur me kalimin në euro dhe se çfarë ndikimi do të ketë kjo në jetën e tyre të përditshme. Menaxherët e kompanive të cilët nuk i kanë pregaditur kompanitë e tyre që të operojnë në euro para përfundimit të vitit do të ballafaqohen me probleme serioze. Kjo nuk do të ndikojë vetëm në transaksionet e tyre bankiere por edhe në operacionet e mbrendshme të



Euro në jetën e përditshme

biznesit të tyre.

Sa i përket transaksioneve kesh BPK ka adoptuar disa rregullore speciale për Kosovë. Shumat deri në 1,000 DM do të shndërrohen në Euro pa provizion. Për shuma më të mëdha do të ketë provizion. Për shumat që kalojnë 10,000DM do të aplikohet rregullorja mbi larjen e parave. Konsumatorët duhet të identifikohen pa marrë parasysh se çfarë shume dëshirojnë të shndërrojnë. Provisioni bankier për këtë shërbim varet nga ajo se sa do të jenë ngarkesat e dërgesave të kesh-it në dhe jashtë Kosovës. I gjithë depoziti kesh para 31 dhjetorit 2001 automatikisht do të shndërrohet në Euro sipas kursit fiks (1EUR=1.95583DM). **E.Q.**

Në këtë numër...

- Kalimi në Euro: Po afron faqe 1
- EICC Kosovë: Ekipi faqe 2
- Ngjarjet EICC: Merrni pjesë në Seminar! faqe 2
- Tregim: Ndërmarrja e përbashkët faqe 2
- Si të regjistroni biznesin në Kosovë? faqe 3
- OEK: Oda Ekonomike e Kosovës faqe 3
- Bashkëpunimi i EICC-së faqe 3
- Panairë: Vizitë në Itali faqe 3
- Financa: Profili i ICU-së faqe 4
- Preferencat tregtare BE-Kosovë faqe 4
- Propozimet afariste me BE: Shansi juaj... faqe 4

Editorial

Nga Ejup Qerimi

Ky është rast special për të thënë faleminderit! Shumë kontribute i takojnë Agjencionit Evropian për Rindërtim. Pa financimin nga AER, Euro Info Qendra Korresponduese nuk do të mund t'i hapte dyert e saj në Kosovë. Më lejoni gjithashtu të falenderoj ekspertët tanë Evropian, katër specialistë të kontraktuar nga fondacioni SEQUA i cili është konsorciumi ynë ndërkombëtar në vendosjen e EICC-së Kosovë. Dhe së fundi, nderim Odës Ekonomike të Kosovës, e cila ka rolin e partnerit tanë mikëpritës. Le të punojmë të gjithë së bashku në mënyrë që të arrijmë qëllimin tonë kryesor, të zgjerojmë perspektivën e ardhshme të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë.

Ne jemi konfident se njerëzit e Kosovës do të kuptojnë se çfarë roli të rëndësishëm mund të luajë EICC-ja në zhvillimin e ekonomisë vendase.

Ky është edicioni i parë i buletinit tonë dymujorë. Pritni numrin e ardhshëm në Dhjetor. Do të ju informojmë!

Përvjetori i parë I Njesisë së Përkohshme Kreditore

Themelimi i një institucioni funksional në Kosovë do të thotë të kalohen shumë probleme dhe pengesa

Njësia e Përkohshme Kreditore (ICU) është duke funksionuar tash e një vit. Ky përvjetor i parë gjithashtu shënon një ngjarje të suksesshme të njërës ndër institucionet më të rëndësishme të Kosovës. ICU deri më tani ka siguruar më se 55 kredi për kompanitë private të regjistruara në Kosovë me vlerë totale prej më se 14 milion DM. Disa nga pengesat që nevojiteshin të tejkalohen nga ICU dhe klientët e tij përfshijnë provizionin e deklaratave financiare për tri vitet e kaluara. Por shumica e të dhënave për klientët kanë qenë të shkatëruara si rezultat i konfliktit, prandaj shumica kanë mundur të pajisën vetëm me të dhënat për vitin 2000. Kjo natyrisht e ka bërë të vështirsuar për ICU-në të gjykojë historinë financiare të shumicës së klientëve të saj. Konflikti gjithashtu ka rezultuar me humbjen e Dokumenteve të Pronësisë për pronat e klientëve që duhet të hipotekojnë në ICU. Klientët e ICU-së kanë qenë të siguar me mundësi huazimi për të ju mundësuar atyre që të blejnë pajisjet, makinerinë dhe lëndën e parë. Prej

tyre është kërkuar që të sigurojnë citatet konkurruese prej së paku tre furnizuesve nga dy shtete të ndryshme. Qëllimi ka qenë që të ju mundësohet furnizuesve në shtetet të cilat e kanë përkrahur Kosovën në rehabilitimin e saj pas konfliktit t'i shesin prodhimet e tyre në Kosovë. Ky proces ka funksionuar mjaft mirë mirëpo ngeçjet e tij janë se klientët Kosovarë nevojitet të vizitojnë fabrikat e furnizuesve të shikojnë pajisjet, të testojnë aftësinë e tyre dhe të kontrollojnë kapacitetin dhe përshtatshmërinë e tyre. Broshurat dhe pamfletat nuk përmbajnë të gjitha përgjegjet. Në disa raste, furnizuesit e huaj kanë pasur përfaqësuesin e tyre lokal apo janë marrë me klientët Kosovarë para konfliktit dhe të dy palët i kanë besuar njëra tjetrës. Sidoqoft, në disa raste relevante klienti është dashur të udhëtojë deri te fabrika e furnizuesit matanë oqeanit. Për këtë, është nevojitur viza e cila ka qenë bllokada më e madhe sepse asnjë ambasadë e huaj nuk është e vendosur në Kosovë. Ambasadat më të afërta janë në Shkup, Maqedoni. Udhëtimi në Shkup ka qenë i kufizuar

dhe kohë pas kohe kufiri ka qenë i mbyllur. Dërguesit e paisjeve, makinerisë dhe lëndës së parë në të shumtën e rasteve vijnë nëpërmes rrugës nëpër Maqedoni dhe konvojet e kamionëve janë mbajtur me javë në atë kohë në kufi. Kjo ka rezultuar në vonimin për të instaluar pajisjet e reja apo për të dërguar lëndën e parë duke rezultuar në humbjen e prodhimit dhe shitjes së ulët.

Përkundër këtyre pengesave, shumica e klientëve kanë arritur që të rrisin prodhimin, Kosova ka qenë në benefiç pas që prodhimet tani prodhohen në vend çka ka reduktuar importin dhe ka zbritur çmimet.

Ndërmarrjet private mund të shikojnë në zyrat e ICU-së në katin e tretë në Rrugën Tiranë numër 35 në Prishtinë, që të kenë takime fillestare me Zyrтарin për Kredi mbi afatet dhe kushtet e detajuara të kredive të ICU-së. Zyra e ICU-së është e hapur prej të Hënës deri të Premtës prej orës 10:00 deri në 11:30 dhe prej orës 14:30 deri në 16:00.

Tim Hooper/ICU

Të kuptojmë Europën Komisioni European

Kosova duhet të kërkoj bashkëpunim

Në kuadër të Unionit European, Komisioni European operon në zemër të procesit të vendimarrjes. Roli i tij si burim i politikës së iniciativave është unik mirëpo ky rol nuk është gjithmonë i kuptuar qartësisht.

Ajo çka është e vështirë të kuptohet për qytetarët e BE-së është sigurisht edhe më e komplikuar për Kosovarët. Megjithatë me paraqitjen e Euros Kosova do të duhet të bashkëpunojë edhe më për së afërmi me Unionin European. Prandaj është e domosdoshme të kuptohet funksionimi i institucioneve Europiane. Të qenurit anëtarë i BE është dëshmuar që u sjell përfitim qytetarëve dhe kompanitë të saj. Përparsitë janë të konsiderueshme: më shumë liri e lëvizjes dhe në të shumtën e rasteve më shumë prosperitet.

Komisioni European punon në partneritet të plotë me institucionet tjera Europiane dhe me qeveritë e Shteteve Anëtare. Edhe pse, komisioni bënë propozimet, të gjitha vendimet kryesore mbi legjislacionin e rëndësishëm merren nga ministrit e Shteteve Anëtare në Këshillin e Bashkimit European, në bashkë-vendim (apo, në disa raste konsultim) me parlamentin European të zgjedhur në mënyrë demokratike.

Njëri prej parimeve është të sigurohet lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe personave në tërë territorin e Unionit. Komisioni gjithashtu duhet të sigurojë se përfitimet e integritit janë të balancuara në mes vendeve dhe regjioneve, në mes bizneseve dhe konsumatorve dhe në mes qytetarëve. Komisioni përbush tri funksione kryesore. Për shkak të së



Pika e mbledhjes së tatimeve në Merdare. Të ardhurat për zhvillim

drejtës së tij për iniciativë, Komisioni është i ngarkuar me propozimet, për të gjitha legjislacionet e reja. Vepron ashtu në bazat të cilat i konsideron si më të mirat për Unionin dhe qytetarët e tij në përgjithësi. Komisioni, për shembull ka bërë përpjekje të mëdha në liberalizimin e telekomunikacionit në Europë, në mënyrë që firmat e UE-së dhe konsumatorët të përfitojnë nga pavarësia e shogërisë informative dhe zhvillimit të mediave. Është dashur të pajtohen interesat e konkurrencës së tregut të lirë me nevojat e garantimit të çasjes në shërbimin universal telefonik me çmime të volitshme për të gjithë qytetarët e saj kudo që jetojnë. Ky është vetëm një shembull. Ekzistojnë shumë më tepër. Nëse u nevojitet rregullore specifike mbi normat e UE, vetëm kontakti EICC-në Kosovë. Ne do tu japim përgjigjen.

MUNDËSITË Propozimet tregtare dhe të bashkëpunimit

EICC-ja Kosovë do të publikojë në secilin edicion të këtij buletini listen me propozime tregtare dhe bashkëpunim. Kompanitë e interesuara Kosovare mund të kontaktojnë EICC në OEK në Prishtinë për detaje të biznesit. Sipërmarrësit Kosovarë mund të kërkojnë ndihmë për të vendosur kontaktet e para direkte me partnerët e tyre potencial të BE-së. Kompanitë Kosovare gjithashtu mund të kontaktojnë EICC-në në qoftë se edhe ata dëshirojnë që propozimet e tyre për tregëti dhe bashkëpunim të distribuohen nëpër kompanitë e BE-së.

-Ref 2001/9/1 Shitës, Austriak me shumicë i kompjuterëve origjinalë, printerëve, kopje dhe fax konsumeve kërkon importues/distributor në Kosovë. Kompania distribuon shirita, ngjyrë dhe tonera kartrigj, media magnetike dhe pajisje të zyrës të më se 150 llojeve siq janë Olivetti, Minolta, Ricoh, Canon, Epson.

-Ref 2001/9/2 Prodhues ITALIAN i kozmetikës kërkon importues/distributorë.

-Ref 2001/9/3 Kompani AUSTRIAKE, e specializuar për pajisje për prodhimin e energjisë elektrike (p.sh. gjeneratorë për energji elektrike) kërkon importues/distributor

Agjensioni European për Rindërtim është përgjegjës për udhëheqjen e programeve kryesore të asistencës së BE-së në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi. Është themeluar në shkurt të viti 2000 me seli në Selanik dhe qendra operuese në Prishtinë, Beograd dhe Podgoricë. Është agjensioni i pavarur i Unionit European që raporton para Këshillit European dhe Parlamentit European. Mbikqyret nga Bordi Udhëheqës i përbërë nga përfaqësuesit e shteteve anëtare të BE-së, dhe i kryesuar nga Komisioni European. Synimet kryesore të Agjensionit European për Rindërtim janë: të bëjnë rindërtimin e menjëhershëm fizik dhe ekonomik; të vendosin themelet për zhvillimin e një ekonomie të tregut; dhe të mbështesin vendosjen e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit.
Për informata të mëtejshme dhe detaje kontaktuese: www.ear.eu.int

Rrëfim: Kompania e përbashkët italo-kosovare

Ndërtimi i hotelit dhe prodhimi i mobileve është iniciativë e dy partnerëve afarist

Kosova ka diasporë të gjërë nëpër gjithë botën, dhe në mesin e tyre shumë sipërmarrës. Ata të gjithë në mënyrë të konsiderueshme kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.

Përveq kësaj, një numër i madh i kosovarëve duke punuar jashtë Kosovës kanë adoptuar aftësi të vlefshme dhe kanë fituar eksperiencë sipërmarrëse. Kjo reflektohet në faktin se shumë investues të jashtëm të interesuar në Kosovë kërkojnë dhe mendojnë të vijnë në Kosovë për një

bashkëpunim të ngushtë me Kosovarët

Njëra prej tregimeve të sukseshme e bashkëpunimit është kompania e përbashkët Italo-Kosovare QMI (Qendra e Mobiljeve Italiane). Ky bashkim kapitali është themeluar në Shkurt të vitit 1999.

Z. Aziz Tafaj, afarist Kosovar i cili ka punuar 10 vite në Itali, ka themeluar kompaninë e vet Tafaj 3HA në Prizren në Tetor 1999. Në Shkurt 2001 në bashkëpunim me Kompaninë Italiane Doimo Group/FD partnerët krijuan bashkim kapitali me një

numër të projekteve. Njëri prej tyre është kompleksi i hotelit.

Partnerët Kosovaro-Italian themeluan kompaninë e tyre të përbashkët në Suhadoll/Lipjan afër rrugës Prishtinë-Prizren. Është parashikuar se investimet do të arrijnë 19.500.000 DM deri në vitin 2003. Lokacioni i ndërtimit përfshinë 18.000 m² dhe kompania do t'i punësoj 275 punëtorë. Planet janë të gatshme për Hotelin me pesë yje me 70 dhoma të fjetjes, 15 apartamente. Gjithashtu, zyrat përfaqësuese për 33 kompani do të jenë në dispozicion në ndërtesë.

Kompanitë e interesuara do ta kenë rastin të bashkëpunojnë me QMI-në.

Partneri Italian është konfidant se ekziston një stabilitet i mjaftueshëm politik dhe siguri nën misionin e Kombeve të Bashkuara, dhe KFOR-it, policisë ndërkombëtare dhe asaj vendase, në mënyrë që t'i ketë të sigurt investimet e bëra.

Nxitës tjetër pozitiv për të krijuar bashkim kapitali në Kosovë janë faktet se ka fuqi punëtoresh të kualifikuara që është më e lirë se çdokund tjetër në Europë, pozita gjeografike e Kosovës në Ballkan si dhe çasja e Kosovës në burimet natyrore.

E.Q.

Ngjarjet dhe seminarët e EICC-së

EICC-ja në Kosovë do të organizojë takime të rregullta, seminare, konferenca dhe sesione trajnimi për komunitetin afarist, direkt apo në bashkëpunim me organizatat tjera. NVM-e Kosovare do të informohen rreth datave dhe vendeve ku do të mbahet ngjarja përmes njoftimeve në gazetata lokale dhe përmes postës direkt te ata persona afaristë të regjistruar me EICC-në. Ju lutem që gjithashtu ti referoheni webfaqes sonë www.kosovo-eicc.org. Ne do t'i ftojme kompanitë dhe organizatat e interesuara që të marrin më shumë informata konkrete mbi ngjarjet e organizuara nga EICC-ja. Ju lutemi kontaktoni zyrën tone me fax, e-mail apo vizitoni qendrën tone personalisht. Ngjarjet e planifikuara tani për tani janë në Tetor 2001: Analizë mbi problemet kryesore të femrës sipërmarrëse Kosovare, përfshirë ato që i përkasin minoriteteve. Nëntor 2001: Konferenca mbi rezultatet e analizës mbi femrën sipërmarrëse Kosovare. Panair ndërkombëtar/ prezentimi i vendit me praninë e delegacionit Italian, përfaqësues të kompanisë që do të vijë në Kosovë. EICC-ja do të organizojë mbledhje me partnerët Kosovarë. Kjo është shansa juaj për biznes! Jeni të ftuar që aktivisht të merrni pjesë në të gjitha aktivitetet tona. Me rëndësi: Udhërrëfyese mbi kalimin në Euro në Kosovë mund që të sigurohet menjëherë. Për informata më të hollësishme kontaktoni zyrën tone në 038-224 596. Zyrtarja për Informim, Erdelina Dula, do të përgjigjet në pyetjet e juaja.

EICC në shërbimin tuaj

EICC-ja në Kosovë është e orientuar drejt ofrimit të shërbimeve. Është një institucion modern European i themeluar në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës. Gjatë fazës fillestare deri në Prill të vitit 2003, ekipi vendas i përbërë nga Drejtori i EICC-së Z. Ejup Qerimi, Zyrtari për Informim Erdelina Dula dhe asistentja Znj. Adriana Merovci do të marrin trajnim të plotë nga një grup ekspertësh ndërkombëtarë. Kjo do të sigurojë që komuniteti afarist i Kosovës do të këshillohet nga një ekip profesional rreth rregulloreve Europiane që prekin sipërmarrësit kosovar.

Para se ti bashkohet EICC-së, Z. Qerimi ka udhëhequr një ndërmarje shoqërore. Drejtori përfaqëson EICC-në dhe është përgjegjës për të gjitha aktivitetet, shërbimet, administratën dhe buxhetin e EICC-së. Ai gjithashtu këshillon kompanitë dhe implementon shërbimet dhe aktivitetet. Ai do të funksionojë si pike kalimi në mes institucioneve kosovare dhe atyre Europiane. Një nga synimet e tij kryesore është të ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të vendosur kontakte afariste me partnerët europian. Zyrtari për informim i EICC-së informon NVM-e rreth rregulloreve dhe standardeve europiane, tregjet dhe programet e BE-së. Ajo iu ofron ndihmë NVM-e rreth gjetjes së partnerëve afarist brenda BE-së. Drejtori së bashku me Zyrtarin për Informim do të bashkëpunojnë ngushtë me rrjetin e EIC-së të përbërë prej rreth 300 Euro Info Qendrave në Europë dhe në rajonin e Mediteranit. Në këtë mënyrë EICC-ja në Kosovë ka çasje në bazën gjithëpërfshirëse të të dhënave.

Në Kosovë, Drejtori dhe Zyrtari për Informim i EICC-së do të vizitojnë kompanitë me qëllim që ti adaptojnë këshillat me nevojat e NVM-e në të



Ekipi i EICC (nga e majta) Znj. Carola Reissland (këshilltar për komunikim), Erdelina Dula (zyrtar për informim), Ejup Qerimi (drejtor i EICC), Adriana Merovci (asistente e EICC) dhe Laura Trevisan (udhëheqëse e projektit)

gjitha sferat e aktivitetit ekonomik.

EICC-ja është e hapur për të gjithë klientët të cilat mund të kërkojnë informata ose asistencë rreth çështjeve të BE-së. Mos hezitoni të vizitoni qendrën e EICC-së në zemër të Prishtinës në Rrugën Nëna Terezë. Zyra gjindet në ndërtesën e Odës Ekonomike të Kosovës në katin e parë.

Qëllimet kryesore të EICC-së janë që të informojnë bashkësinë afariste në Kosovë rreth kornizës rregulative të operimit afarist në Europë, të informojnë kompanitë europiane rreth bizneseve kosovare dhe kornizën rregulative administrative në Kosovë, të ofroj çasje në informatat e BE-së dhe në këtë mënyrë të lehtësoj bashkëpunimin afarist në mes NVM-e Europiane dhe Kosovare.

Shërbimet e ofruara nga EICC-ja përfshijnë informata rreth standardeve europiane (p.sh. paketimit, etiketimit), ndihmë NVM-e në gjetjen e tregjeve, partnerëve në BE dhe krijimit e bashkimit të kapitalit me partnerët europian. Informatat gjithashtu mund të sigurohen përmes kontakteve që ka vendosur kjo qendër me institucionet qeveritare dhe joqeveritare në Kosovë.

Me qëllim të zgjerimit të aktivitetëve informuese një nga detyrat e EICC-së është të organizoj trajnime, seminare dhe konferenca. Në qendrën e EICC-së ju do të gjeni një varg publikimesh, dokumentesh, fletushka.

EICC-ja në Kosovë financohet ng Agjensioni European për Rindërtim. E.D.

SI TË? Regjistrojmë biznesin në Kosovë

Të gjitha bizneset në Kosovë, bazuar në Regullorën e UNMIK-ut 2000/8, duhet të aplikojnë për regjistrim në UNMIK. Sipërmarrësit duhet të regjistrohen në Komunën në të cilën janë duke operuar afarizmin e tyre. Udhëzimet mbi procedurat specifike janë në dispozicion në Komunën e Prishtinës. Regullorja aplikohet për të gjitha llojet e biznesit momentalisht të themeluara në Kosovë apo që do të themelohen. Zyrtarët e Administratës civile së UNMIK-ut llogarisin se deri më tani përafërsisht 70.000 entitete janë regjistruar në tërë Kosovën. Të gjitha bizneset duhet të aplikojnë për regjistrimin e përkohshëm në formularët e aplikimit në dispozicion në të gjitha ndërtesat e komunave dhe të paguajnë tatimin e paktyeshëm administrativ. Tatimet luhaten prej 100 DM për 10 punëtorë dhe 300 DM për më shumë se 10 punëtorë. Regjistrimi në UNMIK do të jetë provizional deri sa Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (PSSGJ) të transferojë autoritetin për të regjistrimin e biznesit në departamentin e përkatës administrativ. Kjo date do të shpallet pas zgjedhjeve në Nëntor. Regjistrimi i afarizmit në UNMIK është i detyrueshëm në mënyrë që bizneset të udhëhiqen në baza ligjore. Regjistrimi i bizneseve siguron informata të rëndësishme administrates civile. Baza e të dhënave është e rëndësishme për të plotësuar bazën e taksave në



OEK - Z. Ismail Kastrati, kryetar i OEK (i treti nga e majta lart), Z. Basri Jupolli, sekretar (i fundit lart) dhe Z. Besim Beqaj, kryesues i Departamentit për marrëdhënie me jashtë (i dyti poshtë)

Kosovë. Çertifikata për regjistrim të biznesit është e nevojshme për të hapur llogari në bankë dhe për të bërë biznese me kompanitë e huaja. Në Komunën e Prishtinës, drejtori i departamentit për Ekonomi dhe Financa, Z. Rrahim Krasniqi, koordinon procesin e regjistrimit të biznesit, i asistuar nga zyrtarë komunalë ndërkombëtarë të UNMIK-ut. Komuna e Prishtinës ka mundësi që të procesojë aplikacionin për regjistrim të biznesit rreth një dite. Momentalisht, gjashtë zyrtarë janë duke punuar me orar të plotë në mënyrë që të sigurojnë informata, pranojnë aplikacionet, i rishqyrtojnë ato dhe i procesojnë ditën e njëjtë **Oriano Micaletti/Komuna e Prishtinës**

Institucionet e Kosovës & Bashkëpunimi i EICC

Me zgjedhjet që do të vijnë shumë gjëra do të ndryshojnë në Kosovë. Organizatat ndërkombëtare që janë të pranishme në Kosovë do të zvoglojnë personelin e tyre, administrata edhe një herë do të riorganizohet dhe personeli vendas do të marrë pozitë kryesore vendimmarrëse. Gjatë dy viteve të fundit që nga intervenimi i NATO-s, nuk ka qenë e lehtë të dihet saktësisht se kush është përgjegjës për çka, cili departament kujdeset për cilin problem. Së paku për komunitetin afarist gjërat së shpejti do të jenë më transparente.

Në mund të iu ndihmojmë për tu drejtuar në organizatat përkatëse, qoftë komuna, administrata lokale ose institucionet e qeverisë së re. Një nga partnerët tanë që bashkëpunojmë është Shtylla e IV-të- Departamenti për Tregti dhe Industri (DTI) i cili do të shndërrohet në ministri qeveritare. DTI-ja sikurse EICC-ja ka ndikim të madh në promovimin e bizneseve në Kosovë me qëllim të përmirësimit të ekonomisë vendase. Përveç kësaj Agjensioni Europian për Rindërtim financiar edhe një tjetër projekt të NVM-e për rritjen e aktiviteteve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ky projekt është i dizajnuar për të themeluar tri Agjensione Rajonale të Ndërmarrjeve (ARN) në Prishtinë, Pejë dhe Gjiilan. Për më tepër EICC-ja bashkëpunon me të gjitha institucionet relevante me departamentin e ndryshme të UNMIK-ut dhe ka kontakte të afërta me të gjitha programet e BE-së. Një partner tjetër i rëndësishëm është Banka Qendrore e Kosovës (BPK) që është përgjegjëse për fushatën e Kosovës mbi kalimin në Euro. Na shkruani për të gjitha problemet që ju shqetësojnë më së shumti!

Çka mund të bëjë OEK për ju

Oda Ekonomike e Kosovës fillimisht është themeluar në vitin 1962 në Prishtinë dhe në mënyrë të vazhdueshme ka zhvilluar aktivitetet e saj deri në vitin 1989. OEK e rifilloi punën menjëherë pas luftës me 24 qershor 1999. OEK-ja është e organizuar në sistem evropian si odë e përbashkët e të gjitha subjekteve ekonomike në Kosovë. OEK-ja është organizatë e pavarur, jopolitike dhe profesionale e cila: -Përfaqëson komunitetin afarist në të gjitha sferat e aktivitetit ekonomik. -Ofron këshilla dhe shërbime afariste me qëllim të rritjes së prodhimit ekonomik - ushtron autorizimet publike në pajtim me ligjet dhe me Statutin. OEK-ja përkrah dhe mbron interesat ligjore ekonomike të sipërmarrësve dhe inkurajon zhvillimin ekonomik. OEK-ja bashkëpunon me organet qeveritare në përpilimin dhe aprovimin e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit ekonomik, zhvillimit rajonal dhe përmirësimit të infrastrukturës ekonomike. Në bazë të ligjit mbi Odën Ekonomike të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 41/79) si dhe në bazë të nenit 1 të rregullores së UNMIK-ut nr. 24/99, anëtarësimi në OEK është i obligueshëm për: të gjitha ndërmarrjet ekonomike që kanë status të personit juridik, bankat dhe institucionet tjera financiare dhe kompanitë e sigurimit. Zejtarët dhe prodhuesit individual bujqësor janë anëtarë kolektiv të Odës përmes shoqatave të zejatrëve ose kooperativave. Në kuadër të Odës janë të organizuara 10 shoqata, 4 këshilla dhe 7 njësi rajonale. Organet qeverisëse të OEK-së janë: Kuvendi i Odës me 83 vende përfaqësuese, Këshilli Drejtues me 19 anëtarë, Kryetari i Odës dhe Këshilli mbikqyrës me 7 anëtarë. OEK-ja u ofron anëtarëve të saj të gjitha shërbimet e parapara me Statut. Po i përmendim në veçanti disa shërbime në lidhje me

Marrëdhëniet ndërkombëtare:

- OEK organizon misionet biznesi, biznese kosovare jashtë dhe anasjelltas
- OEK ndihmon anëtarët e saj të marrin pjesë në panaiere, ekspozita dhe prezantime brenda dhe jashtë Kosovës
- OEK organizon panaiere në Kosovë
- Organizon pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në konferenca, takime, seminare rreth legjislacionit, situatës ekonomike dhe praktikave tregtare.
- Ofron shërbime konsultative dhe shërbime tjera në lehtësimin e lëvizjes jashtë vendit.
- Bashkëpunon me Odën dhe organizatat tjera ekonomike në vende tjera me interes të ekonomisë kosovare
- Ofron informata kompanive të jashtme lidhur me legjislacionin e Kosovës dhe mundësitë e investimeve.
- OEK-ja së shpejti do të fillojë të botojë Gazetën Zyrtare të Odës dhe iu fton për vizitë personale në zyrat e saj.

Oda Ekonomike e Kosovës/Prishtinë



Të rejtat nga Panairi Tregtar në Itali

Zgjerimi i kontakteve ndërkombëtare i ndërmarrjeve kosovare është qëllim i përbashkët i Odës Ekonomike të Kosovës. Në kuadër të Odës, Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë është duke e përcjellur këtë çështje. Iniciativa e kohëve të fundit e Institutit Italian për Tregëti të Jashtme (ICE), me zyrën e tyre në Prishtinë ka qenë jashtëzakonisht e mirëseardhur kur kanë propozuar vizitë në panairin ndërkombëtar në Itali në Shtator. Në bashkëpunim me OEK, EICC-në dhe Departamentin për Tregti dhe Industri (DTI) delegacioni prej gjashtë importuesve kosovarë ka pasur rastin të marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme në Fiera Del Levante/Bari, Itali. Ndërmarrësit kosovarë janë aktivë në sferën e bujqësisë dhe materialeve ndërtimore. Delegacioni ka qenë i përbërë nga: Halim Haxhijaha 'Haxhijaha'-Rahovec, Ekrem Hyseni 'Bibaj AE'-Ferizaj, Gani Krasniqi 'Zgjimi'-Pejë, Hamdi Gashi 'Poljopskrba'-Prishtinë, Mustafë Shala 'Kompakt'-Gjiilan, Avni Krasniqi 'Molitoria'-Vushtri dhe Ejup Qerimi/EICC Kosovë. Gjatë kësaj vizite janë themeluar kontaktet e para me Odën e Tregëtisë, Industrisë, Zejtarisë dhe Bujqësisë në Bari respektivisht me kryetarin e saj Z. Vincenzo Divella i cili ka premtuar bashkëpunim të njëjtë të cilin e kanë me Malin e Zi dhe Shqipërinë